



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.786/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.12.2019 shqyrtoi ankesat me:

**Objekt:** “Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Adastra” shpk nga procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt “*Furnizim e bojra printeri dhe artikuj kancelarie për zyra*”, me Nr. REF- -08-29-2019, me fond limit 3.393.947 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 16.09.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë”.

**Ankimues:** “Adastra” shpk  
Rr.”Lejla Veranda”, Kodra e diellit, nr.2, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kavajë  
Bulevardi “Josif Budo”, Kavajë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 30.08.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt “Furnizim e bojra printeri dhe artikuj kancelarie për zyrë”, me Nr. REF-34555-08-29-2019, me fond limit 3.393.947 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 16.09.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë”.

II.2. Në datën 27.09.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin e ofertave gjatë procesit të vlerësimit, si dhe ofertuesit e kualifikuar dhe të skualifikuar si vijon:

1. Adastra	1,678,000.00 lekë	Skualifikuar
2. Ervin Luzi	2,367,890.00 lekë	Skualifikuar
3. Europrinty Group	3,200,000.00 lekë	Skualifikuar

4. Infosoft Office	1,867,911.69 lekë	Skualifkuar
5. IT Gjergji Computer	2,877,891.11 lekë	Kualifikuar

II.3. Në datën 27.09.2019 operatori ekonomik “Adastra” shpk, është njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi skualifikimin e ofertës për arsye se:  
*" Nga mostrat e verifikuara te sjella me date 16/17.09.2019 disa prej tonerave nuk i plotesojne specifikimet teknike (shtojca 9 ne dst) si me poshte:*

- 1. disa prej tyre jane te rimbushura.*
- 2. nuk kishin ambalazhin origjinal.*
- 3. numri serial i kutise nuk eshte i njejte me marken e pajisjes.*
- 4. nuk ishin sipas pershkrimit perkates ne preventivin e publikuar".*

II.3.1. Në datën 03.10.2019 operatori ekonomik “Adastra” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Konkretisht pretendohet si vijon:

*“Shoqeria "ADASTRA " sh.p.k eshte ofertuese ne proceduren e prokurimin publik te shpallur ne date 30.08.2019 me objekt "Furnizim me bojra printeri dhe artikuj kancelarie per zyra", per te cilen data e mbylljes se ofertave eshte data 16.09.2019 ora 10:00.*

*Nepermjet mesazhit elektronik te sistemit te prokurimit elektronik te APP-se, me date 27.09.2019 jemi njohur me vendimin e KVO-se te Autoritetit Kontraktor , per vleresimin e ofertave dhe skualifikimin e ofertes sone nga kjo procedure prokurimi.*

*Si arsye per skualifikim Autoriteti Kontraktor ka paraqitur arsyen: "NGA MOSTRAT E VERIFIKUARA TE SJELLA ME DATE 16/17.09.2019 DISA PREJ TONERAVE NUK I PLOTESOJNE SPECIFIKIMET TEKNIKE (SHTOJCA 9 NE DST) SI ME POSHTE: 1. DISA PREJ TYRE JANE TE RIMBUSHURA. 2. NUK KISHIN AMBALAZHIN ORIGJINAL. 3. NUMRI SERIAL I KUTISE NUK ESHTË I NJEJTE ME MARKEN E PAJISJES. 4. NUK ISHIN SIPAS PERSHKRIMIT PERKATES NE PREVENTIVIN E PUBLIKUAR"*

*Kete vleresim te kryer nga KVO e kundërshtojme dhe e quajme te qellimshem dhe ne kundërshtim te hapur me frymen e ligjit dhe per kete arsye po paraqesim ankesen tone, me arsyetimin si me poshte vijon:*

*1. Mostrat e dorezuara jane marre ne dorezim nga nje perfaqesues i AK-se dhe nga shqyrtimi i tyre eshte specifikuar se cilesia e mallit eshte shume e mire, duke dhene dhe nje pelqim paraprak, por nuk eshte mbajtur asnje procesverbal per te specifikuar dorezimin dhe gjendjen e mallit me pretendimin se nuk ndodheshin anetaret e KVO-se ne institucion.*

*2. Pretendimi se mostrat nuk i plotesojne specifikimet teknike, per faktin se jane te rimbushura bie automatikisht poshte sepse kete fakt nuk mund ta kostatoni vetem duke pare ambalazhin e*

produktit. Ju si AK nuk i keni hapur mostrat qe te konstatoji nje fakt te tille, dhe keto jane thjesht hamendesime dhe qendrime abstrakte.

3. AK-ja shprehet se ambalazhi nuk eshte original, por ne varesi te shtojces se modifikimit dhe ndryshimet perkatese keni specifikuar se ne baze te nenit 23 te LPP, ju perfshini termin "Ekuivalent " dhe ne kete moment ju keni rene ne kundershtrim me ate cka kerkoni. Si mund te pretendoni ambalazh origjinal kur OE ka te drejte te sjelle mall "ekuivalent" me cilesi te larte dhe ne perputhje me standartet europiane ?!

4. Arsyeja se mostrat nuk ishin ne perputhje me pershkrimet perkatese si ato te preventivit eshte i vertete sepse ne preventiv ju nuk keni specifikuar as kodin OEM dhe cdo moster ka ardhur ne perputhje me ate cka ju keni kerkuar.

Arsyeja e skualifikimit e paraqitur nga Autoriteti Kontraktor eshte absolutisht i pavertete dhe ne kundershtrim te hapur me frymen e legjislacionit ne teresi sepse:

i. Ju si AK ne momentin e marrjes ne dorezim te mostrave nuk keni dhene procesverbal.

Neni 12.2 LPP citon: "Autoriteti kontraktor duhet te mbaje procesverbale dhe dokumentacion te plote per procedurat e kryera ne percaktimin e fituesit te kontrates, ne menyre te tille qe te lejojne kontrollin e zbatimit te ligjit".

Gjithashtu APP me Udhezim Nr.2, date 02.05.2019(bashkangjitur ankeses) specifikon nder te tjera: " Duke qene se dorezimi i mostrave behet prane autoritetit kontraktor, ne baze te parashikimeve te nenit 12 te LPP autoriteti kontraktor duhet te mbaje procesverbale per te administruar procesin e paraqitjes se mostrave, me qellim sigurimin e transparences dhe te integritetit te ketij procesi". Po ashtu, APP ka sjelle ne vemendje te AK faktin qe duhet te mbajne procesverbal dhe te dokumentojne cdo gje gjate procesit te prokurimit.

ii. Neni 1 LPP nder te tjera percakton se : "duhet te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale". Ne si OE jemi paraqitur me oferten ekonomike 1678000 leke pa TVSH ndersa OE i shpallur fitues eshte paraqitur me oferte 2877891 leke pa TVSH. Me nje llogaritje te thjeshte vertetohet se diferenca midis ofertave eshte 1199891 leke pa TVSH. Ju si AK jeni duke i shkatuar nje dem ekonomik dhe shperdorim te fondeve publike shtetit shqiptar dhe jeni ne kundershtrim te hapur me frymen e ligjit.

iii. Ne si OE kemi paraqitur produkte ekuivalente, te standartit European, me te gjitha elementet e sigurise se percaktuar per cdo boje printer dhe fotokopje, neni 23 i LPP, pika 5 dhe njoftimi APP pika 1( shtojca bashkangjitur).

Mbajme pergjegjesi per cdo produkt te ofertuar dhe ofrojme garanci per cilesine e tyre, duke pranuar proven e tyre ne pajisjet perkatese te AK.

Ky veprim nga AK eshte nje diskriminim dhe pengese per OE qe disponojne bojra cilesore, por nuk jane prodhim i kompanive prodhuese te pajisjes, njoftimi APP.

*Ne kete rast, ju si AK, jeni ne kundershtrim te hapur me ligjin, sepse perzgjidhni OE me oferte me te larte dhe skualifikoni pa arsye OE me oferte me te ulet, pa asnje baze dhe me pretendime te paverteta.*

*Nese Autoriteti Kontraktor nuk merr per baze kete ankese, duke kualifikuar oferten e paraqitur nga anajone, atehere do t'i drejtohem Komisionit te Prokurimit Publik, si organ me i larte administrativ, qe shqyrton ankesat e paraqitura nga Operatoret Ekonomik.*

*Per sa me siper, kerkojme nga ana juaj:*

*Anullimin e vendimit te KVO-se per skualifikim te padrejte te OE "Adastra" dhe Shpalljen fitues te Operatorit Ekonomik "Adastra" me oferten ekonomike me te ulet."*

II.3.2. Referuar ankesës së operatorit ekonomik “Adastra” shpk dhe dokumentave bashkëlidhur, rezulton se me anë të shkresës nr.prot.3368/2 prot, date 08.10.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë “Adastra” shpk, ku ka vendosur mospranimin e ankesës, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“OE nder te tjera pretendon se:*

- nuk eshte mbajtur procesverbal per te specifikuar dorezimin dhe gjendjen e mallit*

*Sqarojme se Akti I dorezimit i hartuar nga shoqeria "Adastra" sh.p.k. eshe nenshkruar nga personi i autorizuar z. Jgli Hamollari, vertetuar sipas autorizimit te dates 16.09.2019 i cili ka refernce te njejte me aktin e dorezimin L41826018M. Ne kete rast mund te themi se akt dorezimi ka kryer te njejtin funksion me procesverbalin.*

- AK duke e skualifikuar dhe duke mos e shpallur fitues OE "Adastra" shpk, shkakton dem ekonomik dhe shperdorim te fondeve publike shtetit shqiptar, duke qene ne kundershtrim te hapur me frymen e ligjit.*

*Sqarojme se me oferten e paraqitur nga OE "Adastra" shpk me vleren 1,678,000.00 leke nese do te kualifikohej duke i mare parasysh se plotesonte kriteret, ne zhatim te pikes 5 te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014, oferta e ketij operatori do te vleresohej anomalisht e ulet sepse vlera e saj do te ishte me •e vogel se 85% e mesatares se ofertave te vlefshme”.*

II.3.3. Në datën 15.10.2019, pala ankimuese “Adastra” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtuar përveç pretendimeve të ngritura pranë autoritetin kontraktor, edhe pretendimet sa më poshtë vijon:

*“Referuar edhe kthim pergjigjes me nr.prot 3368/2 se kthyer nga ana e Autoritetit Kontraktor, konstatojme se:*

*pergjigja eshte totalisht e pambeshtetur ne dispozitat ligjore, gjithashtu i referohet edhe nje shoqerie tjeter, konkretisht Shoqerise "DOGEL"shpk, per te cilen nuk kemi asnje lidhje dhe informacion, dhe per me teper nuk ka asnje lidhje me ankesen tone. Pretendimet se Akt-Dorezimi i*

*dorezuar nga ana e Shoqerise "Adastra" sh.p.k është i njejte me procesverbalin është justifikim i AK-se për shkeljet e ligjit. Akt-dorezimi është një dokument individual i nxjere nga ana e shoqerise për të evidentuar dorezimin e mostrave ,dhe është në diskrecion të OE nese e harton apo jo , por nuk ka lidhje me procesverhalin. AK ka detyrim ligjor të mbaje procesverbal ku për çdo moster të dorezuar duhet të konstatojë cilësinë e mallit në respektim të parimit të transparencës;*

*Gjithashtu , pretendimi se edhe nese do kualifikohet oferta jone , do skualifikohet si oferte anomalisht e ulet është thjesht justifikim i pabazuar sepse: e para, nuk jemi skualifikuar për këto arsye, dhe e dyta, në bazë të nenit 66 të VKM nr.914, datë 29.12.2019 , ndër të tjera citohet: "...Nese një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të uleta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e vecanta të ofertes, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP".*

*Në interpretim të nenit të sipercituar, nese do ishte konstatuar ky fakt ka detyrimin ligjor të kërkojë sqarime dhe me pas të vendose për kualifikimin ose jo".*

II.4. Në datën 06.11.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.prot.1627/2 shkresa e autoritetit kontraktor nr.3368/5, datë 04.11.2019, ku bashkëngjitur ndodhet dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes "Adastra" sh.p.k., mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyet : " Nga mostrat e verifikuara të sjella me datë 16/17.09.2019 disa prej tonerave nuk i plotësojnë specifikimet teknike (shtojca 9 në dst) si më poshtë:

1. disa prej tyre janë të rimbushura.

2. nuk kishin ambalazhin origjinal", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 "Specifikime teknike", seksioni 2 "Bojrat e printerit", pika 1 dhe 7, të dokumentave të modifikuara të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimes, si dhe në listën "Furnizimi me bojra printerash dhe kancelari", autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**" 2. BOJRAT E PRINTERIT**

1. Operatori ekonomik duhet te ofroje tonera origjinal me pulle sigurie jo te rimbushur, te prodhuar per te funksionuar me pajisjet qe ajo disponon sipas Product Number (PN).

2.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për letrat dhe tonerat e kerkuara ne preventiv. Mostrat duhet të paraqiten brenda 2 (dy) diteve nga data e hapjes se procedures se prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura”.

*Furnizimi me bojra printerash dhe kancelari*

*Nr. Emri i printerit Njesi Sasi Cmim Per*

*Njesi Vlera*

*1 RICOH MPC 2500 Black Toner Cope 2 -*

*2 RICOH MPC 2500 Yelloë Toner Cope 2 -*

*3 RICOH MPC 2500 Red Toner Cope 2 -*

*4 RICOH MPC 2500 Blue Toner Cope 2 -*

*5 Xerox EëorkCentre 7120 Cope 3 -*

*6 BROTHER HL-5350DN Cope 5 -*

*7 CANON L1121E Cope 7 -*

*8 EPSON EPL6100L Cope 3 -*

*9 HP LASERJET 1018 Cope 45 -*

*10 HP LASERJET 2200D Cope 3 -*

*11 HP LASERJET 1200 Cope 2 -*

*12 HP LASERJET 2430DTN Cope 3 -*

*13 HP LASERJET P1006 Cope 5 -*

*14 HP LASERJET PRO P1102 Cope 12 -*

*15 HP LASERJET P3005D Cope 4 -*

*16 OKI B411DN Cope 24 -*

*17 SAMSUNG Xpress SL-M2070 Cope 4 -*

*18 Samsung Laser ML 2160 Cope 4 -*

*19 SAMSUNG ML 1510 Cope 2 -*

*20 Samsung ML 1665 Cope 20 -*

*21 SAMSUNG SCX-4300 Cope 2 -*

*22 SAMSUNG XPRESS M2675FN Cope 3 -*

*23 XEROX PHASER 3121 Cope 5 -*

*24 XEROX EëORKCENTRE 3210 Cope 1*

*25 HP LASERJET ENTERPRISE P3015 Cope 9 -*

*26 CANON F166400 Cope 6 -*

*27 KYOCER FS-6525MFP Cope 25 -*

*28 LEXMARK MS312DN Cope 4 -*

*29 KYOCERA FS 1010 Cope 1 -*

*30 LEXMARK T652N Cope 10 -*

- 31 Bllok Shenimesh spirale me hapje anash  
(format A4) 50 flete vija Cope 100 -
- 32 Bllok Shenimesh spirale me hapje lart  
(format A5) 70 flete vija Cope 50 -
- 33 Axfenda viti 2019 imitim lekure e zeze cope 10 -  
Furnizimi me bojra printerash dhe kancelari
- 34 Kapese ulluk, shufer libralidhes deri ne 20  
flete cope 20
- 35 USB 32 G Cope 20
- 36 Marrje ëarless USB, largesi mbi 20 m Cope 3
- 37 Prefese lapsash Cope 50
- 38 Hegese teli me mbeshtetese dore plostike Cope 30
- 39 CD me kapacitet 700 mb dhe zarf CD Cope 200
- 40 Dosje Arshive kuti kartoni I forte me hapje  
nga siper, 40 cm \* 30 cm \* 16 cm model  
shteteror, Cope 50
- 41 Dosje e Thjeshte per format A4,kartoni me  
permasa 34 cm \* 25 cm Cope 500
- 42 Dosje me llastik per format A 4 karton I  
forte me shkelqim nga jashte me permasa  
34 cm \* 25 cm  
Cope 1,000
- 43 Dosje me mekanizem 8 cm dhe kutia  
perkatese me shkelqim me permasa 34.5  
cm \* 28 cm \* 8 cm  
Cope 300
- 44 DVD + R me kapacitet 4.7 GB dhe zarf per  
DVD Cope 10
- 45 Evindenciator (marker) ngjyra te ndryshme Cope 150
- 46 Gershere 15 cm Cope 20
- 47 Gome Cope 50
- 48 Kapese Teteshe 50 mm 100 cope/pako Pako 200
- 49 Kapese me Veshe (binderclips) 25 mm Pako 300
- 50 Korrektor Stilo 7 ml Cope 100
- 51 Laps 2B Cope 100
- 52 Lapustile Cope 50
- 53 Leter Format A 4 Rizem 1,450
- 54 Makine kapese (rotatable Stapler) nr 24/6 Cope 100
- 55 Makine kapese deri ne 90 fije 8
- 56 Makine Llogaritese me 30 - 35 butona me 16 shifra (digit) me bateri AA 1.5 V. Cope 40
-



57 Mbajtese kancelarie metalike me shume xhepa Cope 20  
 58 Note me ngitje (stick note) 75 \* 75 mm 100  
 flete Cope 300  
 59 Qese dokumentash pako 100 cope Pako 200  
 60 Rollestick 20 gr Cope 100  
 61 Shirit ngjites transparent I madh Cope 50  
 62 Stilolaps Blu tribal Pensan maja 1 mm Cope 2,000  
 63 Thumb per makine kapese stapler nr 24/6  
 1000 thumba / pako Pako 250  
 64 Vaskete metalike horizontale me 3 kate Set 20  
 65 Vinovil 100 gr Cope 20  
 66 Vizore 30cm Cope 20  
 67 Vizore 50cm Cope 10  
 68 Zarfa A 4 Cope 1,000  
 69 Zarfa A 3 Cope 500 -  
 70 Zarfa B 5 , 6.93 \* 9.84 Cope 1,000 -  
 71 Zarfa DL 4.33 \* 8.66 Cope 4,000 -  
 72 Bojra Uji Pako 2  
 73 rollestick 20 gr Cope 20 -  
 3,393,947  
 678,789.

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.*

III.1.3. Në nenin 23, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një*

*ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin. “*

III.1.4. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimitdhe/ose ...“*

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.6. Referuar dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor, nëpërmjet kësaj procedure prokurimi, kërkon ndër të tjera të furnizohet me tonera (bojra) printer të prodhuara nga kompanitë prodhuese të këtyre pajisjeve, të cilat janë “Ricoh, Xerox, Brother, Canon, Epson, HP, Oki, Lexmark, Samsung, Kyocera” si dhe përcakton në mënyrë eksplicite se tonerat (bojrat) duhet të jenë origjinal me pullë sigurie dhe jo të rimbushur. Sa me sipër, pas verifikimit të mostrave nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit konstaton se shumë prej artikujve, konkretisht tonerave të dorëzuara në cilësinë e mostrës nga operatori ekonomik “Adastra” sh.p.k, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.7. Komisioni thekson se kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të

vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentat e tenderit, apo dorëzimi i qoftë një mostre jo në përputhje me specifikimet tekniqe, përbën shkak për skualifikim. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara. Në rastin konkret mostrat për artikujt e mësipërm të dorëzuara nga operatori ekonomik “Adastra” sh.p.k., konsiderohen se nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit “Adastra” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues ” Adastra” shpk , Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë pasi operatori ekonomik “Adastra” shpk, nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Adastra” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt “Furnizim e bojra printeri dhe artikuj kancelarie për zyra”, me Nr. REF-34555-08-29-2019, me fond limit 3.393.947 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 16.09.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë”.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit, në zbatim të nenit 63 të LPP-së.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1627 Protokoli; Datë 15.10.2019**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar  
Enkeleda Bega**

**Anëtar  
Vilma Zhupaj**

**Anëtar  
Lindita Skeja**

**Anëtar  
Merita Zeqaj**

**Kryetar  
Evis Shurdha**